



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. ~~46~~ datë 19 mars 2019

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR PËRZGJEDHJEN E KANDIDATËVE PËR
PROKUROR TË PËRGJITHSHËM**

Në përputhje me nenin 148/a paragrafi 3 të Kushtetutës, Seksionit I dhe II të ligjit 97/2016 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, (këtëj e tutje Ligji për Prokurorinë) si dhe nenit 159 të ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

Neni 1

Të shpallë fillimin e procedurës për përzgjedhjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm, përmes procedurës së hapur të thirrjes publike për aplikim, bazuar në rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm” të miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

Neni 2

Thirrja për shprehjen e interesit për pozicionin e Prokurorit të Përgjithshëm si dhe kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët do të publikohen në faqen zyrtare të KLP-së si dhe në dy gazeta në nivel kombëtar.

Neni 3

Shprehja e interesit nga ana e kandidatëve duhet të bëhet jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga shpallja e thirrjes në faqen zyrtare të KLP-së dhe të dorëzohet në adresën:

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Rruga “Qemal Stafa” Nr. 1, godina e Prokurorisë së Përgjithshme, Tiranë

Mbi zarf duhet të shënohet: ***“Shprehje interesi për pozicionin e Prokurorit të Përgjithshëm”***.

Aplikimi mund të dorëzohet dhe në formë elektronike në adresën: vendevakante@klp.al (në këtë rast të gjitha dokumentat duhet të jenë të skanuara bashkëlidhur kërkesës për aplikim).

Shprehja e Interesit duhet të shoqerohet me dokumentat e kërkuara në rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm”

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

